



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2022:265144  
Datë: 18.03.2024  
Numri i dokumentit: 05468176

**C.nr.1745/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtarin Fuad Haliti, në kontestin e paditësit G.M, me adresën në rr."A.F", Zhabar, Mitrovicë, kundër të paditurës KRM "Uniteti" me seli në Mitrovicë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Arbnor Thaçi, anulim vendimi dhe kompensim dëmi, pas mbajtje se shqyrtimit kryesor, me datën 18.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. APROVOHET PJESËRISHT** kërkesëpapia e paditësit G.M nga Mitrovica dhe **OBLIGOHET** e paditura KRM "Uniteti" që në emër të shpenzimeve të udhëtimit t'ia paguaj shumën në lartësi prej 55.62€ për periudhën 01.01.2021 e deri me 31.12.2022, me kamatë ligjore prej 8%, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.
- II. REFUZHET** kërkesëpapia e paditësit G.M nga Mitrovica, përtej shumë së gjykuar në paragrafin I të këtij aktgjykimi për pagesën e shumës në lartësi prej 854.38€, në emër të të shpenzimeve të udhëtimit për periudhën 01.01.2021 e deri me 31.12.2022, **si e pabazuar**.
- III. REFUZHET** kërkesëpapia e paditësit G.M me të cilën ka kërkuar që anulohet vendimi i të paditurës nr.283 i datës 13.01.2021, **si i pabazuar**.
- IV. Secila palë** i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**Arsyetim**

**1. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse**

Paditësi, me datën 13.12.2022, pranë kësaj gjykata ka paraqitur padi të cilën e ka precizuar me parashtrësën e datës 27.01.2023 dhe seancën e datës 06.03.2024, kundër të paditurës KRM "Uniteti", me anë të së cilës ka kërkuar që, të anulohet vendimi nr. nr.283 i datës 13.01.2021 për transferimin e paditësit tek Njësia e të paditurës në Vushtrri si i pabazuar në kontratën e punës dhe Ligjin e Punës, si dhe t'ia kompensoj shpenzimet e udhëtimit në relacionin Zhabar i Ulët – Mitrovicë dhe anasjelltas në shumën prej 480.00€, për periudhën prej 01.01.2021 deri me 31.12.2022 dhe shumën prej 430.00€ në emër të pagës për muajin Nëntor të vitit 2022 dhe në pagesën e diferencës në emër të dallimit në mes të pagesave të bëra nga e paditura për të ardhurat personale të paditësit nga Janari i vitit 2021 deri me 31.12.2022 dhe obligimet të të paditurës për pagesën e rrogës së plotë të paditësit.

Paditësi në seancën kryesore deklaroi se qëndroj pranë padisë dhe kërkesëpadiisë dhe të gjitha thëniet që i kam dhënë pranë kësaj gjykate dhe dua të shtoj se gjatë këtyre viteve të punës jam

diskriminuar në pagë, në sistematizim të vendit të punës dhe rreth detyrave dhe përgjegjësi brenda ndërmarrjes p.sh kur është ndarë ndonjë grant nuk kam përfituar, nuk jam pajisur me unifrom të punës, me numër të telefonit dhe jokoooperim transparent brenda ndërmarrjes ku më jepen detyra të dyfishta nga menaxhmenti i ndërmarrjes. Vlenë të theksohet vendimi i vitit 2020 i drejtorit Gazmend Morina i cili thotë se para se G.M të dal në teren ta kontrolloj automjetin dhe në rast incidenti t`i marr përgjegjësitë vetë. Jam i vetmi shofer të cilit i është lëshuar ky vendim. Transferimi im në Vushtrri sipas vendimit të menaxhmentit është bërë për shkaqe humanitare, unë mendoj se ai është bërë në mënyrë të padrejtë sepse kam pasur vështirësi në udhëtim dhe jam dëmtuar materialisht pasi që jam urdhëruar që të shkoj në vendin e punës në ora 6 ku në atë kohë nuk ka pasur autobus dhe jam detyruar të shkoj me veturën time dhe natyrisht kjo ka pasur kosto më të lartë. Jam dëmtuar me paga dhe nuk më ka dhënë askush llogari se ku ka mbetur paga ime brenda ndërmarrjes edhe në bankë, sepse ndërmarrja “Uniteti” ka pasur një marrëveshje me Bankën Ekonomike që ne si punëtor të jemi klientët e saj, meqenëse unë për arsye kreditore jam transferuar në bankën BPB kur kam shkuar ta marrë pagën në bankën time kanë thënë që nuk ki rrugë, kurse kur kam shkuar në Bankën Ekonomike më kanë thënë nuk je i autorizuar me kqyr pasqyrën, në njëfarë mënyrë nuk je klient i yni, ndërsa në ndërmarrje më kanë thënë që t`i qesim rrogat. Është evidente sipas raportit të bankës BPB se jam dëmtuar në paga dhe ato paga ku kanë shkuar unë nuk e di. Gjatë udhëtimit për në Vushtrri kostoja mesatare mujore më ka kushtuar 80 euro përkundër se kam kërkuar që të rikthehem se më kanë premtuar që pas tre muajsh transfer të kthehem ne Mitrovicë gjë që nuk e kanë bërë pas 4 kërkesave të mia. Ekspertizën financiare e kam pranuar dhe kam gjetur disa mangësi ose janë gabime teknike ose të qëllimshme ku mungojnë pagat e udhëtimit që ka qenë në marrëveshje që në fillim të transferit. Nga gjykata kërkoj që për çdo ditë punë të kompensohem nga 1 euro për çdo ditë pune. Dhe kërkoj që gjykata ta shfrytëzoj ndikimin e saj në sistematizimin në vendin e punës. E precizoj kërkesëpadinë sa i përket kërkesës për anulimin e vendimit për transferimin e paditësit tek njësia e të paditurës në Vushtrri vetëm sa i përket numrit dhe datës së këtij vendimi ashtu që vendimi i cili kërkohet të anulohet është vendimi nr. 283 i dt, 13.01.2021.

E paditura në seancën kryesore deklaroj se mbesim në tërësi pranë përgjigjes në padi, deklarimeve të dhëna në seancat e kaluara, po ashtu kundërshtojmë në tërësi pretendimet e paditësit në këtë seancë për dy arsye, e para tek baza e padisë kthimi në vendin e punës në Mitrovicë e cila tanimë nuk qëndron për arsye se i njëjti është kthyer në vendin e tij të punës në Mitrovicë nga data 03.01.2024 pasi që Kompania Uniteti edhe zyrtarisht dhe ligjërisht e ka shuar veprimtarinë e saj në Komunën e Vushtrrisë, ndërsa sa i përket aspektit financiar mendojmë se ekspertiza financiar e të cilën e kemi pranuar i ka qartësuar të gjitha dilemat rreth një borxhi të mundshëm të Kompanisë ndaj punëtorit G.M, po ashtu tek çështja e udhëtimit për të cilën punëtori pretendon se ka pasur marrëveshje me Kompaninë që t`i kompensohet e njëjta marrëveshje është respektuar plotësisht nga ana e kompanisë ku kjo dëshmohet më së miri me listat e pagave të cilat Uniteti i`a ka ofruar gjykatës si dhe paditëse, mjafton një rishikim i thjeshtë i tyre në të cilën decidivisht ceket pagesa për udhëtim e cila punëtorit i kompensohet në vlerën prej 1.40 euro e që është shumë më e lartë nëse vlerësohet me atë të cilën po pretendon tani paditësi gjatë deklarimit në këtë seancë. Ndërsa çështja sa e përket pagave të paditësit të cilat i prezantoj pranë gjykatës lidhur me marrëveshjen ndërmjet kompanisë dhe Bankës Ekonomike nuk qëndron fakti se vetë i njëjti është i vetmi i cili gjendet në një bankë tjetër komerciale për dallim prej punëtorëve të tjerë, por e vërteta është se Banka Ekonomike ka marrëveshje me Unitetin për kryerjen e pagave për të gjithë punëtorët në këtë bankë pastaj është obligimi i Bankës Ekonomike që e njëjta t`i shpërndaj ato në të gjitha bankat komerciale në të cilat janë të lajmëruar punëtorët e Unitetit, rast konkret personalisht jam unë si i autorizuar i cili me llogari bankare operoj në bankën TEB. Kemi punëtor të ndryshëm të cilët në llogaritë e tyre bankare për çështje

interesi operojnë në bankat tjera qoftë edhe ajo arsye të cilën e përmendi paditësi, arsye kreditore, norma interesi apo diçka tjetër. Andaj, duke pasur parasysh gjitha këto të cilat mbështeten edhe në ekspertizën e ekspertit financiar e që i mbështesim edhe ne si kompani edhe njëherë e ripotencoj që mbesim në tërësi prapa tyre.

## ***2. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor***

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: ekspertiza financiare e datës 11.10.2023 dhe ekspertiza plotësuese financiare e datës 18.12.2023 e ekspertit financiar Mujë Ferati, ankesa nr.241/20 e datës 05.11.2020, kontrata e punës nr.1478 e datës 04.11.2022, kontrata e punës nr.486/2012 e datës 01.10.2012, konfirmimi nr.601 i datës 07.09.2022, kërkesa nr.1910 e datës 31.12.2020, vendimi nr.283 i datës 13.01.2021, vendimi nr.627 i datës 13.09.2022 dhe vendimi për pushim vjetor për vitin 2023.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku duke gjetur se kërkesëpadia e paditësit është **pjesërisht bazuar**.

## ***3. Faktet***

Me leximin e ankesës nr.241/20 e datës 05.11.2020, gjykata vërtetoi faktin se paditësit ka bërë asnkasë ndaj vendimit për shkëputjen e kontratës së punës.

Me leximin kontratës së punës nr.1478 e datës 04.11.2022 dhe kontratës së punës nr.486/2012 e datës 01.10.2012, gjykata vërtetoi faktin se paditësit është në marrëdhënie pune tek e paditura si Vozitës i Kamionit.

Me leximin e vendimit nr.627 i datës 13.09.2022 dhe konfirmimit nr.601 i datës 07.09.2022, gjykata vërtetoi faktin se paditësit i është lejuar pushimi pa pagesë për periudhën 01.11.2022 deri me 31.12.2022.

Me leximin e kërkesës nr.1910 e datës 31.12.2020, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka pranuar që të transferohet në Vushtrri me kusht që t'i paguhet shpenzimet e rrugës.

Me leximin e vendimit nr.283 i datës 13.01.2021, gjykata vërtetoi faktin se paditësi përmes këtij vendimi është transferuar në njësinë punuese të KRM "Uniteti" në Vushtrri, në pozitën e njëjtë dhe i është lejuar kompensimi i udhëtimit në shumën prej 1.40€.

Me leximin e vendimit nr.627 i datës 13.09.2022, gjykata vërtetoi faktin se paditësit i është lejuar pushimi pa pagesë për periudhën 01.11.2022 deri me 31.12.2022.

Me leximin e vendimit për pushim vjetor për vitin 2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka qenë në pushim vjetor nga data 16.01.2023 deri me 01.02.2023.

Me leximin e ekspertiza financiare e datës 11.10.2023 dhe ekspertiza plotësuese financiare e datës 18.12.2023 e ekspertit financiar Mujë Ferati, gjykata vërtetoi faktin se për periudhën nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2022, lartësia e kompensimit që i takon paditësit për shpenzimet e udhëtimit është në lartësi prej 55.62€.

#### **4. Ligji i aplikueshëm**

Në bazë të nenit 19 paragrafi 1 i Ligjit të Punës, parashihet që *“I punësuar, me pëlqimin e tij mund të sistemohet përkohësisht, në punë te punëdhënësi tjetër, në bazë të marrëveshjes të të dy punëdhënësve, në vendin e punës i cili i përgjigjet përgatitjes profesionale dhe kualifikimit të tij, në rastet kur: 1.1. është konstatuar se ka pushuar nevoja për punën e të punësuarit; 1.2. ka ardhur deri te ndërprerja e përkohshme e punës ose zvogëlimi i vëllimit të punës; 1.3. hapësirat e punës, respektivisht mjetet e punës iu janë dhënë me qira përkohësisht, punëdhënësit tjetër;”*

Në bazë të nenit 78 paragrafi 1 i Ligjit të Punës parashihet që *“I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura.”*

Në bazë të nenit 79 të Ligjit të Punës parashihet që *“Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente .”*

#### **5. Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës**

Pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqëse dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar pjesërisht.

Gjykata, në bazë të provave të administruara, vërtetohet se paditësi G.M me vendimin nr.283 i datës 13.01.2021, është transferuar në njësinë e të paditurës në Vushtri dhe për këtë i është njohur e drejta në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit në lartësi prej 1.40€ për ditë pune, andaj në bazë të ekspertizës financiare të datës 11.10.2023 dhe plotësimit të saj rrjedh se e paditura nuk i ka paguar paditësit shumën në lartësi prej 55.62€ për periudhën 01.01.2021 e deri me 31.12.2022 dhe për këtë arsye u vendos si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke e obliguar të paditurën që paditësit t’ia kompensojë shumën në lartësi prej 55.62€, komfor vendimit nr.283 i datës 13.01.2021, të cilin vetë e ka nxjerrë.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditësit përtej shumës së gjykuar në paragrafin I të këtij aktgjykimi për pagesën e shumës në lartësi prej 854.38€, në emër të të shpenzimeve të udhëtimit për periudhën 01.01.2021 e deri me 31.12.2022, për shkak se nga ekspertiza financiare dhe sqarimet e ekspertit financiar Mujë Ferati në seancën kryesore, rrjedh se shuma e papaguar në emër të shpenzimeve të transportit për periudhën kontestuese është në lartësi prej 55.62€, andaj edhe kërkesa përtej kësaj shume u refuzuar si e pabazuar.

Gjykata, vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, për shkak se nga provat e administruara u vërtetua faktin se paditësit nuk ka shterrur mjetet e brendshme juridike për goditjen e vendimit nr.283 i datës 13.01.2021, komfor nenit 78 paragrafi 1 i Ligjit të Punës, anulimin e të cilit e kërkon me këtë kërkesëpadi. Paditësi, përveç që nuk ka shterrur mjetet e brendshme juridike për goditjen e vendimit nr.283 i datës 13.01.2021, i njëjti edhe padinë e ka paraqitur jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh (neni 79 i Ligjit të Punës), për shkak se vendimi i

atakuar është nxjerrë me datën 13.01.2021, ndërsa padia me të cilin kërkohet anulimi i këtij vendimi është paraqitur me datën 13.12.2022.

Gjykata, vendosi që mos ta hudh padinë si të pasafatshme, por të vendos me aktgjykim për të njëjtën sepse në kuadër të padisë, paditësi ka paraqitur edhe kërkesë pasurore e cila rezultojë si pjesërisht e bazuar e që kërkesa pasurore nuk ka qenë e lidhur me paraqitjen e padisë në afatin prej 30 ditësh e as me shterren e mjeteve juridike të brendshme.

Gjykata vlerësojë edhe provat e tjera dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse, por të njëjtat ishin pa ndikim dhe jorelevante në vendosjen e kësaj çështje juridike, e posaçërisht vlenë të theksohet ankesa nr.241/20 e datës 05.11.2020 e cila ankesë nuk ka të bëjë me vendimin i cili kërkohet të anulohet në padi, por me një vendim tjetër me të cilin paditësi është suspenduar nga puna, andaj edhe nuk u cilësu si mjet juridik kundër vendimit nr.283 i datës 13.01.2021.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 463 paragrafi 1 i LPK-së i cili parasheh që *“për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën”*, andaj me këtë rast asnjëra palë ndërgjyqëse nuk i kërkojë shpenzimet procedurale.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**  
**Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**  
**C.nr.1745/2022, datë 18.03.2024**

**Gjyqtari**  
**Fuad Haliti**

---

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 dite pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.